



## Argëtohuni duke pikturuar dhe vizatuar

Piktura dhe vizatimi e ndihmon fëmijën të rritë përqendrimin, kreativitetin dhe aftësitë që i duhen për të shkruar.

Përdorni materiale të ndryshme për të shkruar, si shkumësa, lapsa, shkumë rroje dhe bojë. Është shumë argëtuese të përdorni ujë dhe një furçë mbi gurët e pllakat e trotuarit në kopsht.

### Këshillë me yll

Bëhuni kreativ. Nxiteni fëmijën të bëjë shenja, të vizatojë dhe të ngjitë figurat që janë bërë me objekte të ndryshme, si pupla, guaska ose kleçka.

Pritni figurat e preferuara nga revistat dhe bëni kolazhe.



## Si të bëni librin tuaj të kujtimeve

Çfarë ju duhet

- Një libër shënimesh
- Stilolapsa, lapsa me ngjyra dhe lapsa të thjeshtë
- Fotografi
- Revista dhe katalogë
- gërvshërë të parrezikshme për fëmijët
- Ngjitës

Çfarë të bëni

- Ndhmojeni fëmijën të zbukurojë kapakun e librit të kujtimeve Shkruani së bashku emrin e tij.
- Shtoni fjalë ose vizatime të gjërave të tyre të preferuara, si ushqime, vende ose lodra, ose foto të familjarëve ose kafshëve tuaja shtëpiake.
- Mblidhni biletat e autobusit dhe biletat e tjera kur dilni dhe lëreni fëmijën që t'i ngjitë.
- Provoni ta lejoni fëmijën të përdorë xixa, bojë, ngjitëse ose çdo gjë tjetër për ta bërë librin e kujtimeve argëtues dhe plot me ngjyra.

### Ide të vogla për biseda

Flisni për vizatimet e fëmijës suaj dhe pyeteni se çfarë ka vizatuar. Zgjidhni forma dhe pamje që mund të dallohen dhe vizatoni vetë disa prej tyre.

